



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-090

Prishtinë, më 27 maj 2024, ora 10:20
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 27 MAJ 2024

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Saranda Bogujevci, Enver Hoxhaj, Kujtim Shala dhe Bahrim Shabani, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Adnan Rrustemi, Abelard Tahiri, Arben Gashi, Besnik Tahiri dhe Enis Kervan.

Në mbledhje mori pjesë edhe drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme për Shërbime Legjislative, Xheladin Hoxha, në vend të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Stafi përgjegjës i Administratës së Kuvendit për mbështetje Kryesisë së Kuvendit, si dhe nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit, nga grupet parlamentare dhe nga organizatat.

Mbledhjen e kryesoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 28 mars 2024,
3. Seanca plenare, e shtyrë nga data e paraparë që të mbahet më 24 maj 2024,
4. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 20 maj 2024

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 20 maj 2024.

2. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 28 mars 2024

3. Seanca plenare, e shtyrë nga data e paraparë që të mbahet më 24 maj 2024

4. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi të pranishmit se për shkak të fillimit të punimeve për renovimin e sallës plenare të Kuvendit, që kanë të bëjnë me zëvendësimin e pajisjeve teknologjike, gjatë kësaj jave dhe javën pasuese nuk do të ketë seanca, përveç më 12 qershor 2024 mund të mbahet një seancë solemne për shënimin e 25-vjetorit të Ditës së Çlirimit.

Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari procedoi me pikat tjera të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Kërkesa e kryetares së Komisionit për Integrim Evropian, Rrezarta Krasniqi, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Rrezarta Krasniqi dhe Alban Bajrami, u lejohet udhëtimi zyrtar në Berlin (Gjermani), prej datës 3 deri më 6 qershor 2024.
2. Kompensimi i mëditjeve për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit mbulohen nga organizatori - Instituti "Aspen".

2. Kërkesa e kryetares së Komisionit për Integrim Evropian, Rrezarta Krasniqi, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Hungari

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Rrezarta Krasniqi, i lejohet udhëtimi zyrtar në Budapest (Hungari), prej datës 28 deri më 30 korrik 2024.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarën në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Raporti me rekomandime i Komisionit për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, në lidhje me të gjeturat rreth tjetërsimit të pronës së RTP-së dhe të Fakultetit Teknik

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim e ka përcjellë në Kryesi të Kuvendit një raport me rekomandime në lidhje me të gjeturat rreth tjetërsimit të pronës së RTP-së dhe të Fakultetit Teknik.

Ai sqaroi se ky komision e kishte autorizuar një deputet raportues që të zhvillojë hulumtime në lidhje të pronat e RTP-së dhe të Fakultetit Teknik, dhe pas hartimit të raportit me të gjeturat për tjetërsimin e këtyre pronave, Kryesisë së Kuvendit i ka rekomanduar për shqyrtim tri opsione: debat parlamentar, komision hetimor ose dërgim në prokurorinë kompetente. Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

Diskutimi i mëtejshëm për raportin e lartshënuar mbeti për mbledhjen e radhës.

4. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të drekës zyrtare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet në shumën prej 128,00 euro për drekën zyrtare të shtruar nga kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës për kryetarin e Bashkisë së Lezhës dhe të drekës zyrtare në shumën prej 78,00 euro për stafet ndihmëse të kryetarit të Bashkisë së Lezhës dhe të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, më 22. 5. 2024, sipas faturave.

Pikat plotësuese

Në vazhdim, Kryesia i shqyrtoi edhe këto pika plotësuese:

1. Kërkesa e kryesuesit të Delegacionit të përhershëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblesë Parlamentare të Fronkofonisë, Dimal Basha, për lejimin e mbajtjes Sesionit të 36-të të Asamblesë Rajonale të kësaj Asambleje për Rajonin e Evropës dhe për mbulimin e shpenzimeve dhe mbështetjeve tjera organizative dhe logjistike

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet organizimi dhe mbajtja e Sesionit të 36-të të Asamblesë Rajonale Evropiane të Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, prej datës 10 deri më 14 nëntor 2024.
2. Lidhur me sesionin nga pika një (1) e këtij vendimi lejohet shfrytëzimi i sallës plenare të Kuvendit nga data 11 deri më 13 nëntor 2024, si dhe mbulohen shpenzimet sipas kërkesës nr. 08/5440/Do-2408, datë 27 maj 2024.

2. Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, Enver Hoxhaj, për lejimin udhëtimit zyrtar në Austri

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj, i lejohet udhëtimi zyrtar në Vjenë (Austri), prej datës 3 deri më 6 qershor 2024.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Kërkesa e kryetares së Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, për lejimin udhëtimit zyrtar në Bosnjë-Hercegovinë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, i lejohet udhëtimi zyrtar në Sarajevë (Bosnjë-Hercegovinë), prej datës 4 deri më 7 qershor 2024.
2. Shpenzimet për vizë, për sigurim shëndetësor dhe mëditjet për të lartshënuarën në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit mbulohen nga organizatori - OSBE.

4. Kërkesa e deputetit Armend Muja për kompensimin e tejkalimit të shpenzimeve të akomodimit nga udhëtimi zyrtar në SHBA

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Armend Muja, i mbulohen shpenzimet e tarifave për anulimin e rezervimeve të hotelit në shumën prej 651,53 euro dhe për tejkalimin e shpenzimeve të akomodimit në shumën prej 170,45 euro në udhëtimin zyrtar të realizuar në Uashington D.C. (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), prej datës 13 deri më 21 prill 2024, sipas faturave dhe kërkesës nr. 08/5442/Do-2410, datë 27. 5. 2024.

5. Konfirmimi i vendimit në lidhje me udhëtimin zyrtar në Kanada dhe SHBA

Kryesia, në lidhje me udhëtimin zyrtar të lejuar nga Kryetari i Kuvendit, mori këtë:

V E N D I M

Konfirmohet Vendimi i Kryetarit të Kuvendit, nr. 08-V-790, datë 24. 5. 2024, me të cilin deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Mimoza Kusari-Lila, i është lejuar udhëtimi zyrtar në Kanada, prej datës 26 deri më 30 maj 2024, dhe në SHBA, prej datës 30 maj deri më 1 qershor 2024, me kompensimin e mëditjeve, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit mbulohen nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, si dhe nga Vital Voices nga Uashington D.C., SHBA.

6. Kërkesa e nënkryetares së Kuvendit, Saranda Bogujevci, për mbulimin e shpenzimeve nga vizita zyrtare në Lituani

Në lidhje me kërkesën e lartshënuar, nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, e shtroi çështjen e procedurave për blerjen e dhuratave, mjetet financiare për të cilat i kishte miratuar Kryesia e Kuvendit, si dhe për rëndësinë e sqarimeve më të mira për raste të tilla.

Diskutimi i saj i plotë është dhënë në transkript.

Pastaj, Kryesia në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Nënkryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Saranda Bogujevci, njëherësh kryesuese e Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, i mbulohen shpenzimet në shumën prej 189,60 euro për blerjen e dhuratave me produkte vendore të dhuruara në vizitën zyrtare të realizuar në Vilnius (Lituani), nga data 23 deri më 25 maj 2024, sipas kërkesës nr. 08/5444/Do-2412, datë 27. 5. 2024.

7. Seanca solemne për shënimin e 25-vjetorit të Ditës së Çlirimit

Pas diskutimeve, kryetari me konsensus vendosi që seanca solemne e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet të mërkurën, më 12 qershor 2024, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Shënimi i 25-vjetorit të Ditës së Çlirimit.

Po ashtu, me konsensus u vendos që në atë seancë solemne t'u jepet fjala edhe disave nga mysafirët e ftuar.

Në fund, kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri, kërkoi që Projekt-kodi i sjelljes për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës t'i kthehet Komisionit Funkcional për shkak të disa mospajtimeve që i kishte ai në këtë projekt-kod, dhe për të arritur konsensus për miratim.

Diskutimi i tij i plotë është dhënë në transkript.

Në lidhje me kërkesën e lartshënuar të z. Tahiri diskutuan: kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi, dhe përfaqësuesi i GP të LVV-së, Adnan Rustemi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari e mbylli mbledhjen në orën 10:50 minuta.

Glauk Konjufca

Kryetar i Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale